Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/452
Datë: 26.07.2023

Në mbështetje të nenit 4 dhe 23 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës nr. 03/L-189, nenit 6 dhe 16 të Ligjit për Kualifikimet Kombëtare nr. 03/L-060, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë nr. 35/2014, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 19.07.2023 nxjerrë këtë:

VENDIM

1. **Ri-akreditohet dhe ri-validohet** QAP ARNISA- rr. Vitomiricë, Pejë, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 18.12.2022 deri 17.12.2025, me kualifikimet e aprovuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

   1.1 **Modelist, prerës dhe punues të tekstilit dhe të tjerë, Niveli IV sipas KKK,** lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 6 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit për një vit kalendarik në total 4 grupe brenda vitit. Ndërsa numri i kandidatëve për 1 grup mund të jetë maksimalisht 10 kandidatë, për një cikël trajnimi.

   1.2 **Rrobaqepës, prerës dhe punues të tekstilit dhe të tjerë të ngjashëm, Niveli III sipas KKK,** lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 11 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit për një vit kalendarik në total 4 grupe brenda vitit. Ndërsa numri i kandidatëve për 1 grup mund të jetë maksimalisht 10 kandidatë, për një cikël trajnimi.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Në bazë të kërkesës së QAP ARNISA, për ri-akreditim dhe rekomandimeve të dala nga Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi ri-validimin e kualifikimit, si dhe Raporti i ekipit të ekspertëve mbi ri-akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për ri-validim të kualifikimit/modulit; Aplikacionin për ri-akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. QAP ARNISA
2. Arkivit të AKK.

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK